



REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 6433 Prot

Elbasan më, 17.12.2025

NJOFTIM

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së rradhës së Këshillit Bashkiak Elbasan.

Ju njoftojmë se më datë **24.12.2025** ora **13:00** në sallën e Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan zhvillohet mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Elbasan e thirrur nga Kryetari i Këshillit Bashkiak në bazë të Ligjit 139/2015, neni 53 pika 3), me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së Mbledhjes.
2. Miratimi i procesverbalit të muajit Nëntor 27.11.2025
3. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Nëntor 2025
- 3.1. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin Nëntor 2025
4. Mbi emërimin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak Elbasan Z. Elsid Zyma
5. Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028.
6. Për miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2025-2026
7. Miratim për marrje me qira dhe rinovim kontratash të mjediseve për tu përdorur për shkolla dhe kopshte në disa Njësi Administrative të Bashkisë Elbasan
8. Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Elbasan dhe njësive operative vartëse të saj, si dhe saktësimin e emërtesave të njësive operative në tabelat e pagave, nivelet e pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të nëpunësve civilë e të punonjësve të bashkisë dhe njësive operative vartëse të saj për vitin 2026
9. Mbi dhënien në përdorim (pa kundërshpërblim) të ambjentit me emërtim Ish-Godina e Partive Politike (kati i tretë), Z.K 8524, Organizatës së Veteranëve dhe Pasardhësve të LANC nga Bashkia Elbasan
10. Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me nr. 6710 prot datë 02/12/2025 ndërmjet Bashkisë Krushevë (lider) dhe partner: Bashkinë Elbasan, Tjetër Vizion dhe Alka, Programi IPA, Programi Ndërkufitar Republika e Maqedonisë së Veriut - Republika e Shqipërisë, Instrument i Asistencës së Para-Anderimit (IPA II)



- 11.Mbi rinovimin e kontratave një -vjecare të shtetasve të më poshtëm
- 12.Për miratimin e pranimi të një automjete në formën e dhuratës.
- 13.Për miratimin e dhënies me qera të ambjenteve në godinën e pallatit të sportit “Tomorr Sinani”,në lagjen “28 Nëntori”,nga Bashkia Elbasan
- 14.Prezantim dhe diskutim mbi Raportin Vendor të performancës 2024.
- 15.Informacion mbi vlerësimin për nxjerrjen jasht përdorimit të disa aktiveve në ASHPR për vitin 2025

Të ndryshme,

Komisionet do të mbledhen ditën e premte date 19.12.2025 në orën 09:00 në ambientet e Bashkisë Elbasan, salla e mbledhjes së komisioneve.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

LUTFI LALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN
KRYESIA

Nr. ____ prot.

Elbasan më 17. 12. 2025

VENDIM

Nr ____, datë ____. ____. 2025

MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 17, 56, 57 dhe Rregulloren për Organizmin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Elbasan, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Elbasan, në mbledhjen e datës 17. 12. 2025.

VENDOSI

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Elbasan, e cila do të mbahet në datën 19. 12. 2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Elbasan, deputetët e qarkut dhe personat apo /dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i këshillit - Lutfi Lala

Zv. Kryetar i këshillit – Zamir Muzhaqi

Zv. Kryetar i këshillit – Enrieta Ferra

